



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:165769

Datë: 26.01.2021

Numri i dokumentit: 01444187

P.nr.1006/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me asistimin e praktikantës Kaltrina Namani në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. H. me vendbanim në rrugën “.....” nr..... në Ferizaj, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.II.nr.1412/20 e datës 25 Nëntor 2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Paulin Pashku si dhe të akuzuarit me av. mbrojtës me autorizim av. Vllaznim Aliaj me datë 20 Janar 2021 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 26 Janar 2021, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari: Sh. H., i lindur me datë nga i ati M. dhe ëma M. e gjinisë I., me vendbanim në rrugën “” nr. në Ferizaj student, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 11 Gusht 2020, rreth orës 12:15, në rrugën “Rexhep Bislimi” në Ferizaj, i akuzuari me të vërejtur policin nga xhepi e nxjerr dhe e hudh në toke një qese, pastaj pas një kontrolli nga Policia e Kosovës, në afërsi të tij është gjetur një qese me substance narkotike e llojit

marihuanë me peshe të përgjithshme prej 0.62 gram, këtë substance narkotike e ka poseduar pa autorizim, me ç' rast i konfiskohet nga policia.

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale posedim paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2,4,7,8,17,38,39,40,43, 44,69,70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370 dhe 453 të KPP-ës, të akuzuarin Sh. H. e,

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 500 € /pesëqind euro/,te cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 60 /gjashtëdhjetë/ ditëve, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

Gjoba e shqiptuar lejohet të paguhet në dy këste, ku këstin e parë obligohet ta paguaj në shumë prej 250 € /dyqind e pesëdhjetë euro/, në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, ndërsa kësti i dytë në shumë prej 250 € /dyqind e pesëdhjetë euro/, obligohet të paguhet në pjesën e dytë të afatit maksimal prej 60 /gjashtëdhjetë/ ditëve, mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do ti llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

Ne bazë të nenit 269 par. 3 të KPRK-ës, konfiskohen në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 0.62 gram.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /Euro, si dhe shumën prej 30 Euro /tridhjetë/ në emër të kompensimit të viktimave, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m i

Historiku procedurës dhe aktakuza

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh. H. nga Ferizaj rruga “.....” nr....., për shkak të veprës penale: posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP.II.nr.944/20 e datës 26 Nëntor 2020, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 242 par.5 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 20 Janar 2021, në prezencën e prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarit me avokat mbrojtës me autorizim.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të pandehurin në bazë të nenit 246 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzës, në bazë të nenit 246 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-ës, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Pranimi i fajësisë nga i akuzuari

I akuzuari me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se e mbështet avokatin e tij mbrojtës dhe ka shprehur keqardhje dhe është i penduar thellë, i njëjti shton se ishte i moshës së re dhe më nuk ka përsëritur vepra të tilla, tani është rehabilituar dhe

është student në fakultetin e mjekësisë, e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë dhe i premtan gjykatës që nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pranimin e fajësisë i akuzuari e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-ës si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim në pajtim me ligjin .

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Vllaznim Aliaj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka deklaruar: se mbrojturi i tij në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me të për veprën penale për të cilën i vihet në barre, është i moshës së re, student në fakultetin e mjekësisë dhe është i penduar thelle, premtan që më nuk do të përsëris vepra të tilla penale. I propozon gjykatës që të merr parasysh si rrethanë lehtësues pranimin e fajësisë dhe ti shqiptoj një dënim më të butë në minimumin e mundshëm i cili dënim do të arrinte efektin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor fillestar për të gjitha pikat në aktakuza, gjyqtarja e vetme gjykuese për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 edhe përkundër paralajmërimit të akuzuarit për nenin 246 par. 1 të KPPK-ës, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- I akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: raporti i oficerit me numër rasti

2020-DHTN-389 i datës 17.08.2020, raporti i ekspertimit nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë i datës 18.10.2020, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 17.08.2020, deklaratat e të akuzuarit Sh. H. e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj e datës 17.08.2020 si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-ës, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtarja po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprat penale të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjyqtarja e vetme gjykuese vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi: i akuzuari me të vërejtur policin nga xhepi e nxjerr dhe e hudh në tokë një qese, pastaj pas një kontrolli nga Policia e Kosovës, në afërsi të tij është gjetur një qese me substance narkotike e llojit marihuane me peshë të përgjithshme prej 0.62 gr, këtë substance narkotike e ka poseduar pa autorizim, me ç' rast i konfiskohet nga policia, andaj i njëjti është penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtorë për këtë vepër penale.

Caktimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjyqtarja i vetme gjykuese, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin real dhe të sinqertë, moshën e tij të re, student i fakultetit të mjeksësisë kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi

shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkretë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtarja e vetme gjykuese është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me dënim me gjobë dhe me sanksion penal alternativ do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 i KPRK-së, i cili përcakton se *”qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryerësi të mos kryejë vepra penale”*, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryerësit, që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konfiskimi si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me konfiskimin është marrë në bazë të nenit 269 par. 3 të KPRK-ës, andaj i është konfiskuar në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 0.62 gram.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPRK-ës, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.1006/20 me datë 26 Janar 2021

Praktikante:
Kaltrina Namani

Gjyqtarja:
Mimoza SHABANI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovë.

Numri i lëndës: 2020:165769
Datë: 26.01.2021
Numri i dokumentit: 01444187